



Datë: 07.05.2026

A.nr.235/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.235/2026, të datës 03.03.2026, të parashtruar nga ankuesi Xh.D i cilët sipas, kundër organit të punësimit: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 07.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.235/2026 e datës 03.03.2026, e parashtruar nga ankuesi, Xh.D.

A r s y e t i m

Ankuesi, Xh.D (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 03.03.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim se tre inspektorë veterinar dhe tre inspektorë fito sanitar në rajonin e Mitrovicës duhet të vlerësohen nga ankuesi si udhëheqës i tyre, po ashtu ankuesi pretendon se disa nga inspektorat refuzojnë të kryen punën e deleguara nga ana ime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 07.04.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit është e palejuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi Xh.D, sipas vendimit me numër Ref.AUV.01-320/2018 të datës 05.09.2018 nga pozita Koordinator i Zyrës Regjionale në Prishtinë transferohet si Koordinator i Zyrës Regjionale në Mitrovicë në kuadër të njëjtës kategori funksionale dhe gradë.

Ankuesi ne ankesën e datës 03.03.2026 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, i cili pretendon se disa nga inspektoret veterinar dhe fito sanitar duhet vlerësimin e performancës ta bëjë ankuesi, po ashtu ankuesi kërkon nga Këshilli që të nxjerr vendim me të cilin AVUK-un dhe DMZP t'i obligoj që ankuesi të ketë autorizim plotësisht ose pjesërisht, në pushimet vjetore, aprovim të pushimeve, planet periodike të inspektoreve për t'i aprovuar, vlerësimet e rezultateve të punës etj.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se: “Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtë ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.**

Tutje kolegji i këshillit ju referua nenit 37 par 1 të Rregullores NR.01/2011 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, i cili përcakton se: Përgjegjësit e Koordinatorit të zyrës regjionale janë: *1.1 Organizimi i punës së gjithmbarshme të zyrës regjionale dhe menaxhimi i sajë, 1.2.Perkujdesja për sigurimin e kushteve dhe mjeteve të punës, se zyrtareve të zyrës, punë administrative, të logjistikes etj. 1.3 Hartimi i planit të punës së zyrës regjionale, planit kontrolleve zyrtare. 1.4. Sistemimi i inspektoreve dhe dhënia e detyrave të punës. 1.5. Caktimin e lokacionit për inspektim- vendim , subjekti afarist i cili duhet te inspektohet, qëllimin e inspektimit. 1.6. Hartimi i raporteve te punës dhe kërkom i raportimit nga vartësit e tij. 1.7. Bashkëpunimi me institucionet relevante dhe me njësit tjera organizative të agjencisë. 1.8. Raportimi tek shefat e sektorëve përkatës, varësisht nga fusha e veprimit për çështje veterinar tek shefi i sektorit të inspektionit veterinar për çështje fito sanitare tek shefi i inspektionit foto sanitar, për çështjet sanitare tek shefi i inspektionit sanitar dhe tek drejtori i inspektoratit të Agjencisë, i cili përcjell raportet e këtyre tek kryeshefi ekzekutiv i agjencisë nëse kërkohet. 1.9. Kryerja edhe e punëve te tjera te përcaktuara me legjislacionin ne fuqi. Ndërsa në bazë të këtij neni paragrafi 1 nen paragrafi 1.11 është përcaktuar se në zyrat regjionale janë këto pozita: 1.11. Përgjegjësi i inspektoreve (nga dy pozita), të cilët për çështje administrative i përgjigjen koordinatorit të zyrës regjionale ndërsa për çështje profesionale i përgjigjen shefave të sektorëve përkatës. Inspektor Veterinar, Fito sanitar dhe Sanitar. Andaj duke pasur parasysh bazën*

ligjore si me lartë Kolegji konstaton se ankuesit Inspektoret veterinar dhe fito sanitar i përgjigjen vetëm për punë administrative dhe logjistikes ndërsa vlerësimi i rezultateve në punë është çështje profesionale prandaj pretendimi i ankuesit se i njëjti duhet të bëjë vlerësimin dhe të ketë qasje në aprovimin e pushimeve për të lartcekurit nuk është në kompetencë të tij, prandaj ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tij të punës, dhe i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.235/2026 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.235/2026**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi Xh.D;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.